

**VENDIM**

Nr. 29 Date 20.09.2013

**PER MIRATIMIN E PROJEKTIT TE TRASHEGIMISE KULTURORE TE QARKUT  
KUKES**

Keshilli i Qarkut Kukës ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme, pasi shqyrtoi Relacionin dhe P/Vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Hartimit dhe Kordinimit te Projekteve, bazuar ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, nenet 7/2, 8/1b, 54, ligjit Nr.8485, date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative te Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr.9936, date 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", udhezimit te Ministrise se Financave Nr.2 date 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", ligji Nr.9048, date 7.4.2003 "Per trashegimine kulturore"si dhe VKM Nr. 844, date 11.6.2008 "Për miratimin e strategjisë sektoriale të turizmit për periudhën 2007-2013"

**VENDOSI:**

1. Te miratoje projektin "Trashegimia Kulturore e Qarkut Kukës", bashkangjitur ketij vendimi.
2. Financimi i ketij projekti do te behet nga fondet e miratuara te buxhetit te Keshillit te Qarkut.
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Keshillit te Qarkut Kukës, Drejtoria e Hartimit dhe Kordinimit te Projekteve si dhe Zyra e Finances.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETARI**

**Ibsen ELEZI**


Konc: I.Shahu

Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari: B.Ngjeçi

U hartua ne 4 (kater) kopje origjinale:

1. Zyres se Protokoll Arkivit
2. Prefektit te Qarkut Kukës
3. Drejtorise se HKP-se





**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I QARKUT KUKES**



Nr. 888 Prot.

Kukes me 19.09.2013

**TITULLI I PROJEKTIT  
"TRASHIGIMIA KULTURORE E QARKUT KUKËS"**

**I. ORGANIZATORE:**

- KESHILLI I QARKUT KUKES

**II. MBESHTETUR NGA:**

- KESHILLI I QARKUT KUKES
- BISNESE TE MUNDSHME

**III. VENDI I ZHVILLIMIT:**

- Pallati i Kulturës "Hasan Prishtina", Kukës


**IV. KOHA E ZHVILLIMIT : NE DATAT 2 SHTATOR - 15 TETOR**

**V. QËLLIMI**

Të paraqesë ofertën gjeo-kulturore, ku përfshihet e gjithë trashigimia materiale dhe shpirtërore, pjesë e rëndësishme në zhvillimin e turizmit

**VI. SYNIMI:**

Evidentimi dhe ruajtja e trashigimisë kulturore-artizanale





## **VII. OBJEKTIVAT:**

- ❖ Përcaktimi sipas fushave i dhjetë elementëve kryesor të punimeve artizanale
- ❖ Vlerësimi me çmim i punimeve më të mira
- ❖ Përcaktimi i pesë simbolikave të Rajonit

## **VIII. ARSYETIMI I PROJEKTIT:**

Qarku Kukës është një vend i njohur për vlerat e trashëgimisë kulturore. Këshilli i Qarkut Kukës në kuadrin e promovimit të vlerave kulturore të rajonit ( duke e pare si një mbështetje të Strategjisë Së Zhvillimit Rajonal) organizon panairin e punimeve tradicionale.

- Kjo veprimtari jep ndihmesë të madhe në pasqyrimin e vlerave kulturore dhe tradicionale të rajonit tone.
- Në fushën e kulturës ndihmon duke specifikuar objektet tradicionale në vend, gjallërimin e jetës kulturore, nxitjen e zejtarëve dhe artizaneve në krijimtarinë popullore.
- Përcaktimi i simboleve të rajonit
- Nxit prodhimin në funksion të turizmit.

## **IX. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

- Hartimi i një drafti

Përgatitja e draftit mbi trashëgiminë kulturore. Fokusi është vënë në pesë fushat e prodhimeve artizanale si: tekstilet në vek, veshjet tradicionale, punimet në grep, shtiza dhe gjilpërë, punimet në dru, gur dhe metal, veglat e punimeve artizanale dhe muzikore.

Gjatë hartimit të draftit janë bërë disa takime me punonjësit e administratës që mbulojnë fushën e turizmit me të cilët është diskutuar rreth ecurisë së punës.

- Kontaktimi me ekspertët

Përzgjedhja e eksperteve në fushave të ndryshme, njohës të traditës si: historian, etnograf, etj, para të cilëve bëhet prezantimi i draftit, për të marrë mendimet, sygjerimet dhe kritikën për punën që është bërë.

- Njoftimi në media dhe në faqen zyrtare të Qarkut Kukës.

Shpallja e një njoftimi në TV Kukës dhe në website e Qarkut për komunitetin, të cilët duan të bëhen pjesë e panairit me punimet artizanale apo dhe ata që kanë interes ta vizitojnë

- Kontaktimi me prodhuesit

Hartimi i një liste me prodhuesit që do të jenë pjesëmarrës në panair, të cilët do prezantohen me punimet artizanale, si në: vek, veshje, punime dore me grep, shtiza dhe gjilpërë, punime në dru, gur dhe metal.





## REPUBLIKA E SHQIPERISE KESHILLI I QARKUT KUKES



- Ngritja e një komisioni për përzgjedhjen e punimeve më të mira

Krijimi i një komisioni vlerësimi që do të përzgjedhin punimet më të mira të cilat do prezantohen në panair.

- Organizimi i panairit

Përgatitja e ambientit ku do të zhvillohet panairi, i ndarë në sektor sipas punimeve që do paraqiten nga artizanët dhe individët.

- Përzgjedhja e zejtarëve dhe artizanëve që do të merren me prodhimin e produkteve tradicionale.

Do caktohen dhjetë punimet më të mira të artizanëve prej të cilëve do të mbahen kontakte të vazhdueshme që punimet e tyre të vihen në funksion të zhvillimit të turizmit. Gjithashtu do të jepen tre çmime për punimet më të mira me qëllim që të stimulohet prodhimi për të ardhmen në funksion të turizmit.

### X. GRUPET E PUNES PER REALIZIMIN E PROJEKTIT

GLADIOLA ISMAILI

Drejtues Projekti

#### GRUPI ORGANIZATIV

- |                    |             |
|--------------------|-------------|
| 1. VALDETE SINANAJ | Përgjegjëse |
| 2. ARJOLA DOMI     | Antare      |
| 3. ARIETA SPAHIU   | Antare      |
| 4. BESARTA GURI    | Antare      |

#### GRUPI LLOGJISTIKES

- |                     |                        |
|---------------------|------------------------|
| 1. PERPARIM ELEZI   | Përgjegjes             |
| 2. OMER LLUKOVI     | Antar (Infrastruktura) |
| 3. JETMIR AXHAMI    | Antar (inf + web)      |
| 4. MARLEN KARAKUSHI | Antar (Llogjistika)    |
| 5. SHKELQIM OSMANI  | Shoqërues me makinë.   |
| 6. MET CERKEZI      | Ndihmës                |
| 7. BERT MARTINI     | Ndihmës                |



**MIRATON**

**KRYETARI I QARKUT**

**Ibsen ELEZI**

## BUXHETI TRASHEGIMIA KULTURORE

### 1. TABELAT E SHPENZIMEVE DIETA

Nr.	Zerat	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera pa TVSH	TVSH (20%)	Vlera me TVSH
1	Dieta ditore per komisioner	Persona	5	5,000	20,000	5,000	25,000
<b>TOTAL</b>					<b>20,000</b>	<b>5,000</b>	<b>25,000</b>

### 2. TABELA E SHPENZIMEVE ORGANIZATIVE

Nr.	Zerat	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera pa TVSH	TVSH (20%)	Vlera me TVSH
1	Billbord Kryesor 4x3	m2	25	2,400	48,000	12,000	60,000
2	Materiale te ndryshme per panairin		1	20,000	16,000	4,000	20,000
3	Logo + ftesa	cope	100	200	16,000	4,000	20,000
4	Shpenzime organizimi	persona	200	200	32,000	8,000	40,000
5	Koktej	persona	100	1,200	96,000	24,000	120,000
6	Transporti	persona	200	200	32,000	8,000	40,000
<b>TOTAL</b>					<b>240,000</b>	<b>60,000</b>	<b>300,000</b>

### 3. TABELA E SHPENZIMEVE CMIME FITUESE

Nr.	Zerat	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera pa TVSH	TVSH (10%)	Vlera me TVSH
1	Cmimi I Qilim	Punim	1	30,000	27,000	3,000	30,000
2	Cmimi II Qilim	Punim	1	20,000	18,000	2,000	20,000
3	Cmimi III Qilim	Punim	1	15,000	13,500	1,500	15,000
4	Cmimi I Sixhade	Punim	1	30,000	27,000	3,000	30,000
5	Cmimi II Sixhade	Punim	1	20,000	18,000	2,000	20,000
6	Cmimi III Sixhade	Punim	1	15,000	13,500	1,500	15,000
7	Cmimi Veshjet	Punim	1	30,000	27,000	3,000	30,000
8	Cmim Punim me grep	Punim	1	10,000	9,000	1,000	10,000
9	Cmim punim me shtiza	Punim	1	10,000	9,000	1,000	10,000
10	Cmim punim me qendisje	Punim	1	10,000	9,000	1,000	10,000
11	Cmim Punime ne dru	Punim	1	10,000	9,000	1,000	10,000
12	Cmim Punime ne metal	Punim	1	10,000	9,000	1,000	10,000
13	Cmim veglat e punimeve muzikore	Punim	1	10,000	9,000	1,000	10,000
14	Cmim Veglat e punimeve artizanale	Punim	1	10,000	9,000	1,000	10,000
<b>TOTAL</b>					<b>207,000</b>	<b>23,000</b>	<b>230,000</b>

### TABELA PERMBLEDHESE

	Vlera pa TVSH	TVSH (20%)	Vlera me TVSH
1 TABELA E SHPENZIMEVE DIETA	20,000	5,000	25,000
2 TABELA E SHPENZIMEVE LLOGJISTIKA	240,000	60,000	300,000
3 TABELA E SHPENZIMEVE CMIME FITUESE	207,000	23,000	230,000
<b>TOTAL (Vlera ne Lek)</b>	<b>467,000</b>	<b>88,000</b>	<b>555,000</b>

Specialist i Investimeve  
Arjola DOMI




KRYETARI  
Ibsen ELEZI

